



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 84/5 prot.

Tiranë, më 23.2.2024

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 729, datë 10.1.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Zena Lila
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datë 12.2.2024, është njoftuar vendimi nr. 729, datë 10.1.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Zena Lila, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor, nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 729, datë 10.1.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Zena Lila, ushtron detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan dhe, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Lila, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale.

3. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuar për këtë subjekt nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*referuar në vijim si ILDKPKI*), Raportin e vlerësimit të hartuar nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (*referuar në vijim si DSIK*) dhe Raportin e vlerësimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (*referuar në vijim si KLP*).

4. Nga raportet rezulton se:

4.1 **ILDKPKI**², në “Aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Zena Lila”, ka konstatuar:

- (i) *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- (ii) *Ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurive;*
- (iii) *Ka mosdeklarime të pasurive ndër vite;*
- (iv) *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

4.2 Institucioni kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit dhe të dhënave të tjera, me qëllim përcaktimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar, ish-DSIK, me anë të Raportit³ mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, znj. Zena Lila, ka referuar: “Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit...”.

4.3 **KLP**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin⁴ për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Zena Lila.

5. Përfundimet e Komisioni, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

5.1 *Lidhur me kriterin e pasurisë.* Në analizë të përgjithshme, pasuria e subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës së rivlerësimit përbëhet nga një shtëpi e ndodhur në ***, një automjet tip “Ford Fusion” dhe një pasuri *Bono Thesari*, në vlerën 3.860.000 lekë, e krijuar me kursimet e punës së pandërprerë prej vitit 1992, për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin e saj. Rezultati negativ financiar gjatë vitit 2005 për shkak të pretendimit, por mosprovimit të shumës 1.100.000 lekë, si e përfituar nga shitja e shtesave të shtëpisë në Gramsh, rezultati negativ në vitin 2007 dhe rezultati negativ gjatë viteve 2010 – 2016, që dukshëm ka ardhur për shkak të pasaktësive në deklarime e bëra ndër vite të kursimeve *cash*, në frymë të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk përbën shkak të qëllimshëm të

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij Aneksi dhe ligjit.

² Me shkresën nr. ***/** prot., datë*.12.2019.

³ Me shkresën nr. ***/** prot, datë **.10.2017.

⁴ Raporti i KLP-së nr. **** prot., datë **.7.2023.

penalizimit me masën disiplinore të shkarkimit, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në tërësi vlerësohet se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë sipas nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016⁵.

5.2 *Lidhur me kriterin e figurës*, trupi gjykues ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Zena Lila, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016⁶.

5.3 *Lidhur me kriterin e vlerësimit profesional*, nga analiza në tërësi e këtij kriteri rezultoi se subjekti ka arritur një nivel të kënaqshëm, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016. Duke konsideruar faktin që znj. Zena Lila ka një karrierë të gjatë në sistem dhe ndaj saj në Komision ka pasur vetëm një denoncim shkresor, në vlerësimin tërësor për Komisionin, kjo përbën tregues të një pune të bërë në përgjithësi me përgjegjshmëri, pa konfliktime apo pakënaqësi prej viktimave apo denoncuesve⁷.

6. Në përfundim, Komisioni, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, duke çmuar se subjekti: (i) ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; (ii) ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; (iii) ka arritur një nivel të kënaqshëm kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja “a” dhe nenit 59, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur (ndër të tjera, si pjesë e dispozitivit):

- *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Zena Lila, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan.*

II. Shkaqet e ankimit

7. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

8. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si Kolegji).

9. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

10. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues, vlerësim të

⁵ Referohuni vendimit të Komisionit, faqe 20, prg. 25.6 dhe 25.7.

⁶ Referohuni vendimit të Komisionit, faqe 20, prg. 30.

⁷ Referohuni vendimit të Komisionit, faqe 24, prg. 40.

drejtë të provave, si dhe në përputhje me jurisprudencën orientuese të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

11. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, konstaton se nga shqyrtimi i vendimit nr. 729/2024, çmon se ai është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

12. Për sa më sipër, Komisioneri Publik, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 729/2024, të Komisionit, në tërësinë e tij.

II.A Analiza e shkaqeve të ankimit

13. Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

14. Sa më sipër, Komisioneri Publik, në analizë të akteve në dosje, lidhur me shpjegimin bindshëm të ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurive të subjektit, ndër të tjera, konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, në deklaratat periodike vjetore dhe atë “Vetting”, kanë deklaruar pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si më poshtë listuar:

15. Shtëpi banimi e përbërë nga dy dhoma, një kuzhinë, me sipërfaqe 99,9 m², * * ***, ***, Tiranë**

15.1 Në D.-Vett., subjekti ka deklaruar: Shtëpi banimi e përbërë nga dy dhoma, një kuzhinë, me sipërfaqe 99,9 m², blerë me kontrate nr. *** rep., dhe nr. *** kol., ndodhur në rrugën “****” pallati “****” sh.p.k., kati i parë, Ap. *, *** * ***, ***, Tiranë. Vlera e deklaruar e pasurisë është 61.480 euro. *Burimet e krijimit: Kjo pasuri është krijuar nga (1) kursimet e të ardhurave familjare dhe (2) shitja e një shtëpie që kemi patur në Gramsh, përfutur me statusin e ushtarakut, paguar 79.712 lekë dhe shitur ... në vlerën 500.000 lekë. Po ashtu edhe (3) shitja e një magazine, tualete, pjesë toke pa dokumentacion, në vlerën totale 1.100.000 lekë, si dhe (4) të ardhura familjare nga kursimet, si dhe interesa bankare nga viti 1997⁸.*

15.2 Në DV-2008, subjekti ka deklaruar: “Prenotim apartamenti 2+1 në Tiranë, me sipërfaqe 116 m², nga shoqëria me administrator *** ***. Shlyer 55.000 euro dhe detyrimi i mbetur është deklaruar në vlerën 8.000 euro. Në bazë të deklaramit, rezulton që total detyrimi për shitblerjen e apartamentit të ketë qenë 63.000 euro. Nga dokumentacioni që është administruar nuk rezultojnë të deklaruara detyrime ose pagesa ndaj ndërtuesit në DV-2009 dhe DV-2010.

⁸ Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës, ndër të tjera: (1) kontratën e shitjes të kësaj pasurie të paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.12.2011, me palë blerëse *** *** dhe palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k., në të cilën parashikohet se pala shitëse ka rënë dakord që të shesë këtë pronë palës blerëse, kundrejt shumës totale prej 61.480 euro, pagesa e së cilës është bërë jashtë kësaj zyre noteriale, si dhe (2) certifikatë për vërtetim pronësie, datë **.1.2012, për këtë pasuri.

15.3 Në DV-2011, subjekti ka deklaruar: Lidhur kontrata e shitjes për apartamentin 2+1, me sip. 99,9 m² në ***, Tiranë, në dt. **.12.2011, me nr. *** rep., nr. *** kol, pasuri e regjistruar në ZRPP Tiranë, me nr. ***/***+*-*, në **.1.2012. Subjekti ka deklaruar se, *me përcaktimin e sipërfaqes së bërë me hartimin e kontratës, është përcaktuar vlera totale e apartamentit 61.480 euro, shuma 55.000 euro, paguar në vitin 2008 dhe e deklaruar nga unë po në vitin 2008, ndërsa diferenca 6.480 euro, është paguar në 2011, pra me lidhjen e kontratës së shitjes.*

15.4 Në përgjigje të pyetësorit nr.1., subjekti, ndër të tjera, mbi mënyrën e shlyerjes së vlerës së kësaj pasurie, ka deklaruar se: [...] *Pagesa për këtë apartament, shtëpi banimi është bërë nga viti 2008 deri në vitin 2011. Burimi financiar për këtë blerje është nga të ardhurat nga pagat, depozitat bankare, si dhe shitja e një shtëpie dhe objekteve të tjera të lidhura me të, në qytetin Gramsh. Mënyra e pagimit për këtë pasuri është bërë me dy këste në vitin 2008; më datë **.5.2008-30.000 euro dhe me datë **.8.2008-25.000 euro, të marra nga depozitat bankare që kemi pasur. Pjesa e mbetur në vlerën 6.480 euro është likuiduar në vitin 2009[...]⁹.*

15.5 (I) Lidhur me burimin e deklaruar, në D-Vetting, në vlerën 500.000 lekë, nga shitja e një shtëpie në Gramsh, Drejtoria Vendore e ASHK-së Gramsh, ka përcjellë në Komision dosjen e pasurisë, nga e cila rezulton se bëhet fjalë për pasurinë e llojit “Apartament”, me sipërfaqe totale 247 m², nga kjo sipërfaqe trualli 247 m² dhe sipërfaqe ndërtese 92,71 m², e ndodhur në Zonën Kadastrale ***. Kjo pasuri ka qenë pronë e Entit Kombëtar të Banesave dhe, në vitin 2002, kjo pronë është përfituar nga *** ***, *** *** dhe Zena Lila, për vlerën 79.712 lekë.

15.5.1 Subjekti i rivlerësimit, bashkëshorti dhe shtetasja *** *** (motra e bashkëshortit), rezulton se pasurinë e llojit *apartament*, me sipërfaqe 247 m², nga kjo truall 247 m² dhe ndërtesë 92.71 m², ia kanë shitur, me kontratën e shitblerjes nr. *** rep. / *** kol., datë **.2.2005, shtetasit ***. ***, **për vlerën 500.000 lekë.**

15.5.2 Lidhur me këtë pasuri, nga verifikimi i akteve në dosje, deklaratave periodike vjetore ka rezultuar se në DV-2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si pasuri: Apartament 2+1, të ndodhur në qytetin e Gramshit, me sipërfaqe ndërtese 92,7 m² dhe totale 247 m². Privatizimi i banesave ushtarake nga EKB (përfituar me status ushtaraku falas).

15.5.3 Në vijim, referuar akteve në dosje, nuk duket që subjekti të ketë deklaruar shitjen e kësaj pasurie në deklaratat periodike vjetore, por vetëm në deklarinimin periodik të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: *Depozitë bankare në Bankën e Kursimeve, Gramsh, vlera 2.300.000 lekë, datë 1.2.2005, shitur shtëpia.*

15.5.4 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se shtetasja *** ***, nuk ka përfituar asgjë nga shitja e kësaj pasurie, si dhe ka përcjellë në Komision, deklaratë noteriale nr.*** rep., nr. *** kol., datë **.8.2023, në të cilën znj. *** *** (***) , ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *Deklaroj se nga shitja e banesës që kemi përfituar në *** –Gramsh nga EKB, unë, *** ***, nuk kam përfituar asnjë të ardhur. Unë, pas martesë, me pëlqimin tim, nuk kam kërkuar pjesë në banesë, pasi ia kam lënë për të banuar vëllait tim, *** ***. Mbi këtë fakt nuk është hartuar ndonjë dokument, pasi kanë qenë marrëdhënie ndërmjet vëllait dhe motrës. [...]*

⁹ Në bazë të deklarimeve të subjektit në këtë apartament kanë filluar të jetojnë fëmijët e saj në momentin që filluan studimet e larta në Tiranë (rreth nëntorit 2013). Sa i përket kontratave të utiliteteve, UKT ka përcjellë informacionin se për këtë pasuri rezulton të ketë një kontratë aktive furnizimi me ujë, në emër të *** Lila, me faturime që nga qershori i vitit 2012. Ndërsa FSHU informon komisionin se *** *** ka një kontratë furnizimi me energji elektrike, e cila është aktive nga korriku i vitit 2009.

15.6 (2) Lidhur me burimin e deklaruar në D-Vetting, shitja e një magazine, tualete, pjesë toke pa dokumentacion në vlerën totale 1.100.000 lekë, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit e deklaroi këtë burim për herë të parë në Deklaratën “Vetting” dhe nga aktet nuk rezultoi të ketë paraqitur ndonjë dokumentacion justifikues mbi posedimin e kësaj pasurie dhe të ardhurat e pretenduara të përfituara.

15.6.1 Komisioni i ka kërkuar subjektit të provojë vërtetësinë e deklarimeve në D-Vetting, si dhe të paraqesë në mënyrë të saktë dhe të plotë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] Shtëpi banimi Gramsh,...përfituar me statusin e ushtarakut nga *** ***... Pas përfitimit të kësaj shtëpie në të është investuar duke u ndërtuar garazh, magazinë dhe tualet, ku këto shtesa nuk janë regjistruar në ZVRPP. Në vitin 2005 është bërë shitja e banesës së bashku me garazhin, magazinë dhe tualetet, ku shitja është dokumentuar me kontratën nr.*** rep./** kol., datë **2.2005 [...].

15.7 Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi ka arritur në konkluzionin se:

- Subjekti i rivlerësimit ka kryer pagesën për këtë pasuri në vitin 2008, në shumën 55.000 euro, por ajo rezultoi në pamundësi financiare ndër vite për krijimin e kësaj shume, po ashtu edhe për pagesën e kryer në vitin 2011.

- Nga hetimi i llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të (bashkëshortit) rezultoi se bashkëshorti derdh në bankë shuma parash cash, për të cilat deri në këtë moment mbetet i paprovuar burimi i ligjshëm i tyre.

- Subjekti rivlerësimit rezultoi në pamundësi financiare në shumën -2.330.231¹⁰ lekë, për krijimin e shumës 55.000, përdorur për kryerjen e pagesës në vitin 2008 dhe -274.633 lekë, për kryerjen e pagesës në vitin 2011, në total – 2.604.864 lekë, për krijimin e pasurisë apartament banimi, me sipërfaqe 99,9 m², ndodhur në ***, Tiranë, në vlerën 61.480 euro.

15.8 Subjekti i rivlerësimit, në prapësime, ka kundërshtuar analizën e kryer nga Komisioni duke pretenduar, ndër të tjera, rishikimin e llogaritjeve të kryera nga ana e Komisionit mbi likuiditetet gjendje në llogaritë bankare të saj dhe të bashkëshortit, rishikim të shpenzimeve të jetesës për periudhën që nga viti 1992 në përputhje me standardin e vendosur nga Kolegji, si dhe përfshirjen në analizë të shumës 1.100.000 lekë, si të ardhur nga shitja e pasurisë truall + ndërtesë (garazh) në vitin 2005, duke deklaruar, ndër të tjera, se këto veprime ndërmjet *** ***, blerësit të pasurisë, dhe *** ***, bashkëshortit, janë kryer në rrugë bankare.¹¹

15.8.1 Së bashku me prapësimet, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dhe deklaruar materiale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **1.2022, në të cilën shtetasi *** *** (trashëgimtari ligjor i shtetasit *** ***, të cilit subjekti dhe personat e lidhur i kanë shitur shtëpinë), ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] Në vitin 2005, babai im ka blerë nga familja e *** *** një truall me sipërfaqe 247 m² dhe ndërtesa prej 92,71 m², që dokumentohej me dokument pronësie. Krahas këtij trualli dhe ndërtesë është blerë dhe një sipërfaqe trualli prej 200 m², si dhe pjesë godine si garazh, magazinë e rrethuar me mur rrethues, si dhe materiale ndërtimi që gjendeshin në objekt etj., por që për këto të fundit *** *** nuk dispononte dokument pronësie dhe fakti i

¹⁰ Duket se Komisioni ka llogaritur këtë diferencë duke analizuar periudhën 2004-2007, në mënyrë komulative, referuar f. 4, të rezultateve të hetimit.

¹¹ Për më tepër referohuni prapësimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti.

*blerjes nuk është pasqyruar në kontratën e shitjes të lidhur ndërmjet familjes së *** dhe babit tim...Trualli i regjistruar dhe i paregjistruar së bashku me ndërtesën dhe shtesat e bëra, i janë shitur babait tim, ***, **, ne vlerë totale 1.600.000 lekë... Nga vlera totale prej 1.600.000 lekë, babai im, shumën prej 1.400.000 lekë, e ka kaluar nëpërmjet bankës, ndërsa shumën prej 200.000 lekë e ka paguar cash. Kjo provohet dhe nga veprimet bankare [...].*

15.9 Komisioni, për sa më sipër, ka vendosur në dukje mospërputhshmërinë e deklarimeve të subjektit në seancë dhe në prapësime të paraqitura nga vetë ajo, në lidhje me evidentimin e shumës 1.600.000 lekë, të përfituara nga shitja e shtëpisë në Gramsh, pasi subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e paraqitura me shkrim, ka theksuar se veprimet ndërmjet bashkëshortit të saj dhe blerësit, ***, **, janë kryer në rrugë bankare, ndërsa në seancë përfaqësuesi i subjektit të rivlerësimit pretendoi se shuma 1.400.000 lekë ka qenë gjendje në llogarinë e shtetasit ***, **, ku është tërhequr cash dhe i është paguar cash shtetasit ***, **, së bashku me 200.000 lekë, që i kishte jashtë sistemit bankar¹².

15.10 Nisur nga sa më sipër, për të provuar pretendimet e subjektit, Komisioni ka vendosur të riçelë hetimin administrativ për të siguruar informacionin e nevojshëm nga *** Bank, në lidhje me gjendjen e llogarisë së shtetasit ***, **, në momentin e shitblerjes së pasurisë në Gramsh.

15.11 Nga dokumentacioni i administruar pas riçeljes së hetimit administrativ, në lidhje me gjendjen e llogarisë bankare të shtetasit ***, **, rezultoi se në llogarinë e tij në Bankën e Kursimeve (tani ****) dega Gramsh, figuroi vetëm një depozitë prej 4.200 euro, e cila është tërhequr nga llogaria në datën **.12.2004. Nuk u konstatua tërheqje e shumës 1.400.000 lekë apo e një vlere të përafërt nga ana e këtij shtetasi apo e familjarëve të tij, në datën **.2.2005, në momentin e shitblerjes së shtëpisë në Gramsh.

15.12 Në përfundim, Komisioni, duke konsideruar të gjitha provat dhe pretendimet e subjektit, arriti në konkluzionin se nuk ka rrethana që mund të dokumentojnë ekzistencën e shitjes së 200 m² truall, së bashku me sipërfaqe ndërtimore të paregjistruara dhe përfitimin e vlerës 1.100.000 lekë, në vitin 2005. Vetëm deklarimi i depozitës, me vlerë 2.300.000 lekë, në DV - 2004, me burim shitjen e shtëpisë, është i pamjaftueshëm në kuptim të vlerës së provës për të argumentuar ekzistencën e këtyre sipërfaqeve dhe vlerën e pretenduar prej 1.100.000 lekësh për shitjen e tyre.

15.13 Komisioneri Publik, për sa më sipër, lidhur me burimin e deklaruar: “*shitja e një magazine, tualete, pjesë toke pa dokumentacion, në vlerën totale 1.100.000 lekë*”, ndan të njëjtin qëndrim si Komisioni dhe vlerëson se pretendimet e subjektit nuk u provuan me dokumentacion edhe pas riçeljes së hetimit administrativ.

15.13.1 Referuar jurisprudencës së Kolegjit¹³, Komisioneri Publik arsyeton se edhe deklarata noteriale e shtetasit ***, **, e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, merret me rezervë në këtë proces, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe për shkak të tij, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit. Marrja me rezervë e kësaj deklarate noteriale, forcohet sidomos kur përmbajtja e

¹² Pretendimit për ekzistencën e kësaj gjendjeje lekësh në llogarinë e shtetasit ***, **, përfaqësuesi i subjektit të rivlerësimit i bashkëlidhi korrespondencën me punonjësien e *** Bank, sipas së cilës, vetë subjekti nuk mund të kërkonte informacion për shtetasin ***, **, duke qenë se përbënte “sekret bankar”. Nga ana tjetër, Komisioni kishte të drejtë ta siguronte këtë informacion, i legjitimuar nga ligji nr. 84/2016.

¹³ Referohuni vendimit të Kolegjit (JR) nr. 29/2020, 34/2019, 11/2019 etj.

saj nuk mbështetet dhe nuk është në harmoni me provat e administruara në procesin e rivlerësimit edhe pas riçeljes së hetimit administrativ, në përfundim të të cilit mbeti e paprovuar si ekzistenca e pasurisë, ashtu dhe të ardhurat e pretenduara të përfituara prej saj, në vlerën 1.100.000 lekë.

15.13.2 Në këto kushte, në vlerësimin e Komisionerit Publik, burimi i deklaruar i të ardhurave prej 1.100.000 lekë, i deklaruar vetëm në Deklaratën “Vetting”, si burim krijimi për pasurinë *Shtëpi banimi e përbërë nga dy dhoma, një kuzhinë, me sipërfaqe 99,9 m², *** * ***, ***, Tiranë*, mbeti në nivel deklarativ dhe i paprovuar me dokument shoqërues, për rrjedhojë këto të ardhura nuk kalojnë testin e provueshmërisë e, për pasojë, edhe testin e ligjshmërisë së tyre.

16. Depozitë Bankare në * e Shqipërisë, Bono Thesari në vlerën 3.860.000 lekë**

16.1 Në D-Vett., subjekti ka deklaruar: Depozitë Bankare në *** e Shqipërisë – Bono Thesari në vlerën 3.860.000 lekë, me burim kursimet nga paga e saj si prokurore dhe ajo e bashkëshortit si mjek.

16.2 Në DV-2010, subjekti, për herë të parë, ka deklaruar: Depozitë bankare në *** e Shqipërisë, 1.000.000 lekë. Pjesa takuese 50%¹⁴.

16.3 Komisioni, fillimisht, ka kryer analizën financiare të subjektit për periudhën 1993-2003 dhe 2003-2016, duke marrë në analizë të ardhurat, shpenzimet dhe investimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për periudhat deri në fund të viteve respektive. Nga analiza pasqyruar në rezultatet e hetimit administrativ, ka rezultuar pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme në shumën – 4.368.990 lekë¹⁵, diferencë për të cilën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ¹⁶.

16.4 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka pretenduar se ka pasur pasaktësi në deklarimet periodike të viteve 2003-2004, mbi likuiditetet e disponuara në llogaritë bankare, të cilat kanë ardhur si rezultat i paqartësisë lidhur me mënyrën e deklarimit, duke paraqitur dhe disa akte të reja mbi depozitimet e kursimeve në banka.

16.5 Për vitet në vijim (2005, 2007 dhe 2011), subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se të ardhurat nga pagat mbulojnë kursimet dhe shpenzimet vjetore, duke pretenduar se shtesat në depozitime bankare, me qëllim investimin në Bono Thesari, kanë pasur si burim kursimet e mëparshme të poseduara në *cash*. Në pretendimet e saj, subjekti, gjithashtu, ka kërkuar edhe

¹⁴ Nga verifikimi i transaksioneve bankare kanë rezultuar: (i) në dt.**.6.2010, bashkëshorti i subjektit ka depozituar në *cash*, në bankën ***, shumën 1.000.000 lekë, e cila do të investohej në blerje Bono Thesari, në *** nga z. *** ***. Gjendja e likuiditeteve në ***, në dt. **.12.2010, është në shumën 1.000.000 lekë, në emër të *** ***. (ii) Është çelur Bono Thesari në ***, në dt. **.2.2011, në shumën 1.000.000 lekë, në emër të *** ***, dhe në datën **.6.2011, nëpërmjet bankës ***, është kryer transaksioni, duke depozituar *cash* shumën 500.000 lekë, nga llogaria e *** ***, e investuar për blerje Bono Thesari në ***. (iii) Depozitim *cash*, në datën **.06.2012, nga z. *** ***, në llogarinë e pagës te *** Bank, në shumën 500.500 lekë, dhe transferuar për t’u investuar në Bono Thesari në ***. (iv) Në datën **.1.2013, është depozituar në ***, llogari në emër të *** ***, shuma 500.500 lekë, dhe është transferuar për t’u investuar në Bono Thesari te ***, në emër të *** ***. (v) Gjendja e likuiditeteve të investuara në Bono thesari në ***, në dt. **.12.2013, është në shumën 3.500.000 lekë.

¹⁵ Në këtë diferencë, Komisioni ka përfshirë dhe pamjaftueshërinë e vitit 2005, që vjen, ndër të tjera, si rezultat dhe i mospërfshirjes së shumës 1.100.000 lekë, pretenduar si e ardhur e përfitur nga shitja e pasurisë në Gramsh, trajtuar në pikën 1.

¹⁶ Komisioni ka, gjithashtu, edhe kryer analizën financiare në momentin e depozitimeve si më sipër, nga e cila ka rezultuar mungesë likuiditetesh për krijimin e tyre, konkretisht për depozitimimin e likuiditeteve në vitin 2010, mungesë fondesh në shumën -636.063 lekë, shtesat në vitin 2011, në shumën -1.027.326 lekë, dhe shtesat e vitit 2013, në shumën - 402.431 lekë. Subjekti rivlerësimit ka rezultuar në pamundësi financiare në shumën -2.065.820 lekë, për investimin në Bono Thesari, në vlerën 3.860.000 lekë, të deklaruar në D-Vett. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

përfshirjen në mesin e burimeve të ligjshme të shumës 1.100.000 lekë, si e ardhur nga shitja e pasurisë në vitin 2005 (trajtuar më sipër), për krijimin e depozitave bankare.

16.6 Në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, Komisioni ka vlerësuar se: [...] nga analiza e përgjithshme financiare rezulton se, për periudhën 2003 – 2016, subjekti i rivlerësimit është me vlerë negative prej -1.683.809 lekësh¹⁷. Trupi gjykues çmon se situata faktike e gjendjes cash, gjatë viteve 2010 – 2016, dukshëm nuk është deklaruar saktë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratimet periodike vjetore, përderisa nuk krijon vijueshmëri logjike dhe as harmoni me deklarin e gjendjes cash në Deklaratën Vetting. Po ashtu, nuk rezultojnë pasuri të tjera të krijuara apo shpenzime të mundshme të kryera nga familja e subjektit të rivlerësimit, të cilat mund të krijojnë dyshime të arsyeshme se deklaratimet e pasakta mund të ishin të qëllimshme. Rezultati negativ financiar mbi gjendjen e pamjaftueshmërisë financiare të subjektit, të krijuar për vitet 2010 – 2016, është i ulët në krahasim me vlerën 3.100.000 lekë, të krijuar nga akumulimi i gjendjes cash, ndaj në vlerësim të trupit gjykues, kjo gjendje mund të mos reflektojë situatën faktike të subjektit. Leximi më koherent dhe logjik i gjendjes cash, të deklaruar për vitet 2010 – 2016, është që gjendja cash të jetë gjendje e krijuar gjatë vitit të deklaratimit deri në Deklaratën Vetting. Në analizë të përgjithshme, pasuria e subjektit të rivlerësimit përgjatë periudhës së rivlerësimit përbëhet nga një shtëpi e ndodhur në ***, një automjet tip “Ford Fusion” dhe një pasuri Bono Thesari, në vlerën 3.860.000 lekë, e krijuar me kursimet e punës së pandërprerë prej vitit 1992, për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin e saj. Rezultati negativ financiar gjatë vitit 2005, për shkak të pretendimit, por mosprovimit të shumës 1.100.000 lekë, si e përfutuar nga shitja e shtesave të shtëpisë në Gramsh, rezultati negativ në vitin 2007 dhe rezultati negativ gjatë viteve 2010 – 2016, që dukshëm ka ardhur për shkak të pasaktësive në deklarime të bëra ndër vite të kursimeve cash, në frymë të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk përbën shkak të qëllimshëm të penalizimit me masën disiplinore të shkarkimit sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në tërësi vlerësohet se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë sipas nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 [...].

16.7 Komisioneri Publik, për sa më sipër, nuk ndan qëndrim dhe vlerësim të njëjtë me Komisionin, pasi përpos sa trajtuar më sipër, në shkaqet e ankimit mbi mospërfshirjen në mesin e burimeve të ligjshme të shumës 1.100.000 lekë, e pretenduar si e ardhur nga shitja e pasurisë në vitin 2005 (çka do të rezultonte pamjaftueshmëri financiare e këtij viti në të njëjtën shumë) në vlerësimin e Komisionerit Publik, pamjaftueshmëria financiare për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, për vitet e analizuara, do rezultonte e ndryshme nga pamjaftueshmëria e konstatuar nga Komisioni në funksion edhe të rivlerësimit të zërave: (i) shpenzime jetese për vitin 2007 dhe (ii) kursime në cash ndër vite.

16.7.1 Më konkretisht, rezulton se Komisioni, në analizën financiare të vitit 2007, ka llogaritur shpenzimet e jetesës jo në përputhje me standardin e përdorur në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, bazuar në korrespondencën me ILDKPKI-në¹⁸. Nga rishikimi i këtij zëri në analizën e vitit 2007, shpenzimet e jetesës do të rriteshin në vlerën 397.392 lekë dhe, po me të njëjtën vlerë, do rritej dhe pamjaftueshmëria financiare e konstatuar nga Komisioni¹⁹, duke arritur një vlerë negative që nuk mund t'i nënshtrohet parimit të proporcionalitetit të

¹⁷ Përkatesisht: - 1.453.999 lekë, në vitet 2005 – 2007, për krijimin e likuiditeteve bankare dhe gjendjes cash në vitin 2007; në vlerën -11.503 lekë, në vitin 2011, për pagimin e kështit të fundit të pasurisë shtëpi banimi, me sip. 99.9 m², por edhe të shtimit të pasurisë Bono Thesari, si dhe në vlerën -218.307, në vitin 2012, për shtimin e pasurisë Bono Thesari.

¹⁸ Referohuni vendimit të Kolegjit (JR) nr. 18/2022 prg. 27.1.

¹⁹ Diferenca në këtë rast do të shkonte në shumën – 2.081.201 lekë.

parashikuar nga neni 52, pika 1 e ligjit nr. 84/201648, në përputhje me standardet e vendosura nga jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit.

16.7.2 Përveç sa më sipër, Komisioneri Publik konstaton se, edhe arsyetimi dhe trajtimi në vendimin objekt ankimi, i kursimeve në *cash* të subjektit të rivlerësimit ndër vite, bie ndesh me jurisprudencën orientuese dhe tashmë të konsoliduar të Kolegjit. Komisioneri Publik sjell në vëmendje praktikën e konsoliduar të Kolegjit²⁰, e cila ka vlerësuar deklarinin e subjekteve të rivlerësimit në deklarinimet periodike të interesave, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Pavarësisht nga ndryshimet që ka pësuar ligji nr. 9049/2003 dhe formulari i deklarinimit, në rubrikën përkatëse, faqja 3 e formularit, që i përket pasqyrimin të shtesave dhe ndryshimeve të interesave privatë dhe pasurive të paluajtshme e të luajtshme, ligji, në mënyrë konsistente, ka kërkuar që subjektet deklaruese të shprehen për: [...] ndryshimet (shtesa dhe pakësime) nga “deklarinimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarinimit”, që lidhen me zyrtarin, bashkëshortin/en dhe fëmijët madhorë [...]. Legjislacioni në fuqi ka qenë i qartë, duke parashikuar që deklaratat përbëjnë dokumente zyrtare dhe mospërmbushja e këtij detyrimi sillte pasoja për subjektet deklaruese.

16.7.3 Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, nga viti 2007 e në vijim, kanë deklaruar në formularin ku kërkohet të deklarohen shtesa dhe pakësime të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, kursime të likuiditeteve *cash*, me termin: “Kesh në dorë”, çka referuar dhe jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit, për qëllime të këtij procesi, duhet të konsiderohen si shtesa vjetore²¹. Vetëm në DV-2011, subjekti ka deklaruar: “*Pakësuar gjendje cash e deklaruar më parë të deklaruara - 1.300.000 lekë*”.

16.7.4 Të njëjtin deklarinim ka kryer subjekti i rivlerësimit edhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të Komisionit, kur ka shpjeguar se: *në deklaratat periodike vjetore të periudhave 2007-2010, shumat e deklaruara si gjendje cash përfaqësojnë vetëm sasinë e lekëve cash të kursyera vetëm për vitin përkatës të deklarinimit...pra pasqyrohen vetëm shtesat për atë vit deklarinimi*. Në të njëjtin pyetësor, subjekti ka deklaruar se, vetëm në vitin 2011, ka pasur pakësim të kursimeve në *cash* në vlerën 1.300.000 lekë.

16.7.5 Përveç sa më sipër, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, nuk rezulton të kenë deklaruar në asnjë nga deklaratat periodike vjetore, përdorimin e kursimeve *cash*, si burim për krijimin e likuiditeteve në llogaritë bankare.

16.7.6 Subjekti i rivlerësimit, vetëm në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, ka pretenduar se si burim për krijimin e këtyre likuiditeteve (depozitimeve *cash* në llogaritë bankare, të cilat janë investuar në formën e bonove të thesarit, vendosur pranë Bankës së Shqipërisë), kanë shërbyer kursimet e viteve të mëparshme, disponuar në *cash*, pretendim të cilin duket se Komisioni e ka marrë në konsideratë dhe reflektuar në analizën financiare të kryer për periudhën 2010 e në vijim, duke arritur në vlerat e pamjaftueshmërisë financiare, të referuar në vendimin e arsyetuar²².

16.7.7 Bazuar në sa më sipër, referuar jurisprudencës së Kolegjit në vendimet orientuese mbi mënyrën e llogaritjes së kursimeve *cash* dhe deklarinimeve të subjektit gjatë hetimit

²⁰ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 11/2019 (JR); nr. 19/2019 (JR); nr. 20/2019 (JR) dhe nr. 27/2020 (JR).

²¹ (JR) nr. 11/2019, në prg. 27.12.18; (JR) nr. 19/2019, në prg. 84, 85; (JR) nr. 20/2019, në prg. 59; (JR) 7/2019, prg. 39; (JR) nr. 27/2020, prg. 18.

²² Referohuni prg. 20.6 -20.15, të vendimit të Komisionit.

administrativ, Komisioneri Publik vlerëson se arsyetimi i Komisionit mbi trajtimin e kursimeve *cash* dhe mbulimin e shpenzimeve dhe kursimeve me burime të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe pasaktësitë në deklarin e kursimeve *cash* nga ana e subjektit (fokusuar në vitet 2010-2016), nuk përputhet me gjendjen që janë aktet në dosje²³.

16.7.8 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, analiza financiare e subjektit të rivlerësimit duhet kryer duke llogaritur për çdo vit kursimet në *cash* si shtesa të kursimeve dhe pa pakësuar kursimet e akumuluar në vitet e mëparshme, në përputhje me deklarinet në deklaratat periodike vjetore. Pakësimi i kursimeve në *cash* duhet të reflektohet vetëm në vitin 2011, referuar deklarinimit periodik të këtij viti dhe deklarimeve të subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të Komisionit. Gjithashtu, referuar jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit²⁴, kursimet në likuiditete *cash*, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, nuk duhen konsideruar si kursim i mbartur dhe i akumuluar, në vitet pasardhëse, nëse nga analiza financiare e vitit respektiv nuk rezulton mbulim i kursimeve *cash* me burime të ligjshme.

16.7.9 Si rezultat i kryerjes së analizës financiare bazuar në argumentet e mësipërme, përveç pamjaftueshmërisë financiare, konstatuar për krijimin e likuiditeteve në vitin 2005, në shumën – 1.100.000 lekë (likuiditete, të cilat duket se janë tërhequr në vitin 2008 dhe kanë shërbyer për pagesën e kështit të parë të apartamentit), do të rezultonte dhe pamjaftueshmëri financiare për periudhën 2007-2016, në vlerën - 1.650.803 lekë²⁵.

16.7.10 Përveç sa më sipër, referuar analizës financiare përfundimtare të paraqitur nga Komisioni²⁶, Komisioneri Publik vëren se, në analizimin e burimeve të ligjshme të vitit 2004, nga Komisioni, në zërin e të ardhurave, është përfshirë nënzëri “*Mundësi për kursim*”, në shumën 1.439.534 lekë²⁷, pasi Komisioni ka vlerësuar pretendimet e subjektit se në DV- 2003, pavarësisht se duhej deklaruar gjendja e pasurive në datën 31.12.2003, nga ana e subjektit është deklaruar gjendja e depozitave të kursimit/likuiditetit në atë kohë në Bankën e Kursimeve në datën 17.3.2004.

16.7.11 Komisioneri Publik mban në konsideratë qëndrimin tashmë të konsoliduar të Kolegjit se mosdeklarimet me korrektësi në vite të subjektit të rivlerësimit e afektojnë procesin e tij të rivlerësimit në drejtim të pamundësisë së verifikimit të vërtetësisë së deklarimeve në D-Vetting, të cilat prezumoheshin për shkak të ligjit se duhej të mbështeteshin e provoheshin me anë të deklarimeve në deklaratat periodike.

16.8 Duke përfunduar, Komisioneri Publik vlerëson se: (i) pamjaftueshmëria e konstatuar si më sipër me burimet e deklaruara të përdorura për krijimin e pasurisë *apartment banimi*, me sip. 99,9 m²; (ii) pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme në krijimin e depozitave të investuara në formën e bonove të thesarit dhe mbulimin e shpenzimeve të periudhës së analizuar, të dyja së bashku janë të tilla që e bëjnë deklarin e subjektit të rivlerësimit, për

23 Duket se Komisioni, në analizën përfundimtare, pasqyruar në vendimin e arsyetuar, ka reflektuar pakësim të kursimeve në *cash* të subjektit të rivlerësimit edhe për vitet për të cilat nga subjekti nuk ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore pakësim të kursimeve në likuiditete *cash*.

²⁴ Referohuni vendimit (JR) nr. 18/2022 të Kolegjit, prg. 31.2.

²⁵ Diferencë që përbëhet prej: - 635.303 lekë, për vitin 2007, duke konsideruar shpenzime jetese sipas standardit të përdorur nga KPA, shtesë kursimesh *cash*, në shumën 500.000 lekë, dhe shtesës së likuiditeteve në llogaritë bankare; -76.717 lekë, për vitin 2008, duke konsideruar shtesë kursime në *cash* në vlerën 600.000 lekë; - 386.108 lekë, për vitin 2010, si rezultat i shtesës së gjendjes *cash* të vitit 2010, në shumën e deklaruar +400.000 lekë; -112.503 lekë, në vitin 2011, si rezultat i pakësimit të kursimeve *cash* të vitit 2011, në shumën e deklaruar -1.300.000 lekë; -220.308 lekë, për vitin 2012, si rezultat i shtesës së gjendjes *cash* të vitit 2012, në shumën e deklaruar + 700.000 lekë; -219.864 lekë, për vitin 2016, si rezultat i shtesës së gjendjes *cash* të vitit 2014, në shumën e deklaruar + 700.000 lekë.

²⁶ Referohuni faqes 18 të Vendimit të Komisionit.

²⁷ Nga analiza financiare, kjo shumë duket se është diferenca (të ardhura – pasuri – shpenzime 4-3-5) e vitit 2003.

kriterin e kontrollit të pasurisë, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

III. Kërkimi i ankimit

17. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës dhe aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

18. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

19. Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit;

20. Bazuar në nenin Ç, D, E dhe F të aneksit të Kushtetutës, Kreun VI, nenin 4, pika 2, dhe nenin 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016;

21. Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 729, datë 10.1.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Zena Lila.

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO